

SUNDIMI I LIGJIT: EULEX KA SHUMË PUNË PËR TË BËRË



Më 09 Prill 2010, Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL) publikoi raportin vazhdues për punën e EULEX-it, me titull "EULEX: Ende në kërkim të identitetit", si vazhdim i raportit vlerësues për punën një vjeçare të EULEX-it "EULEX: Duke kërkuar identitetin", i cili u publikua më 27 Dhjetor 2009. Raporti i parë kishte përfunduar me një listë të rekomandimeve për EULEX-in, Qeverinë e Kosovës, BE-në dhe Përfaqësuesin Special të BE-së (PSBE).

EULEX-i vazhdon të ketë problem me imazhin e tij. Qëllimet e zbardhimit të këtij misioni në Kosovë ishin sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe krimet të organizuar. Por, pavarësisht entuziazmit të treguar në fillim dhe pritjeve të mëdha shumë pak arritje ka në këtë drejtim. Kosova është paraqitur dhe paraqitet si vend me nivel të lartë të korrupsionit në raporte ndërkombëtare vazhdimisht. Mungesa e arritjeve në luftën kundër korrupsionit po ndikon në rrënjëzimin e mëtejme të tij në institucionet Kosovare.

Çështja e reformës së gjyqësorit nuk është marrë me seriozitet deri më tani. Fatkeqësisht, nuk vërehet ndonjë vullnet politik të asnjë nga aktorët e përfshirë për të shpejtuar reformat në gjyqësor. Një problem shumë i madh mbetet numri i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, në krahasim me numrin e policëve. Gjykatat në veri që u mbyllën në vitin 2008, ende nuk janë funksionalizuar plotësisht. Tani kjo gjykatë funksionon vetëm me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë.

Pikat doganore 1 dhe 31 ende nuk janë funksionale. Aktualisht këto pika janë duke funksionuar me zyrtarë të EULEX-it që vetëm bëjnë regjistrimin e hyrjes dhe daljes së mallrave, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit doganor. Në këtë drejtim EULEX-i prapë është i kufizuar në operim duke pritur një marrëveshje politike mes Prishtinës dhe Beogradit. EULEX nuk është duke doganuar mallrat fare në pikat 1 dhe 31. Kjo është status quo-ja në veri tash sa i përket doganave dhe duket se nuk do të ndryshojë së shpejti.

NGJARJET E

ARDHSHME:

Tryezë e rumbullakët mbi konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Tryezë e rumbullakët për komunat e reja.

PUBLIKIMET

TONA: EULEX: Në kërkim të identitetit (Raporti i vlerësimit të punës njëvjeçare të EULEX-it).

Analizë për ligjin e prokurimit publik.

Reforma e pushtetit lokal dhe sistemi zgjedhor.

PROJEKTET TONA:

Konkurrenca, prokurimi dhe mbrojtja e konsumatorit.

Ndërtimi i komunave të reja.

Raporti krahasues mbi Ballkanin Jugor.